



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KUVENDI

*Kryetari*

Nr. 315 prot.

Tiranë, më 27.01.2021

**URDHËR**

Nr. 6, datë 27.1.2021

**PËR MBLEDHJEN E KUVENDIT NË SEANCË PLENARE, DATË 01.02.2021, ORA 10.00**

Në mbështetje të nenit 27/1 të Rregullores së Kuvendit, bazuar në kalendarin tre javor të punimeve të Kuvendit për periudhën 18 janar - 5 shkurt 2021,

URDHËROJ:

- I. Mbledhjen e Kuvendit në seancën plenare të datës 01.02.2021, ora 10:00.
- II. Rendi i ditës i seancës plenare është si më poshtë:
  1. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të datës 28.01.2021
  2. Njoftime
  3. Interpelancë me ministrin e Shtetit për Diasporën kërkuar nga grup deputetësh
  4. Raport i veprimtarisë së grupit të deputetëve “Miqtë e fëmijëve”
  5. Projektligji “Për azilin në Republikën e Shqipërisë”
  6. Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9251, datë 8.7.2004, “Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”
  7. Projektligji “Për ratifikimin e protokollit ndryshues të marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës, për shmangien e tatimit të dyfishtë lidhur me tatimet mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin për parandalimin e evazionit fiskal, ratifikuar me ligjin nr. 62/2014”
  8. Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Bashkimit Evropian, në lidhje me programin vjetor kombëtar për Shqipërinë për vitin 2019, në kuadër të instrumentit të asistencës së paraanëtarësimit (IPA II)”
  9. Projektligji “Për ratifikimin e Protokollit ndryshues të marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Dukatit të Madh të Luksemburgut për shmangien e tatimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal, lidhur me tatimet mbi të ardhurat dhe kapitalin, e nënshkruar në Tiranë më 14 janar 2009, ratifikuar me ligjin nr. 10094, datë 12.03.2009”.
  10. Projektvendim “Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës së Institutit të Studimeve të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit në Shqipëri (ISKK)”.
  11. Projektvendim “Për emërimin e një anëtarit të Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare”.
  12. Diskutime për çështje jashtë rendit të ditës (60’)
- III. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për marrjen e masave mbrojtëse të nevojshme për parandalimin e përhapjes së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19 në seancë plenare.

IV. Ngarkohen Shërbimet e Kuvendit për publikimin e rendit të ditës të seancës plenare, njoftimin e anëtarëve të Kuvendit me anë të mjeteve të komunikimit elektronik si dhe përgatitjen e dokumentacionit parlamentar që do të shqyrtohet.

V. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R I

**Gramoz RUÇI**





# SEANCË PLENARE PUBLIKE

E hënë, 1 shkurt 2021, ora 10.00

## RENDI I DITËS

Në mbështetje të Urdhrit nr. 6, datë 27.1.2021 të Kryetarit të Kuvendit, z. Gramoz Ruçi, rendi i ditës është si më poshtë vijon:

1. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të datës 28.01.2021.  
*(Neni 44, pika 2 e Rregullores)*
2. Njoftime.  
*(Neni 44, pika 3 e Rregullores)*
3. [Interpelancë me ministrin e Shtetit për Diasporën kërkuar nga një grup deputetësh.](#)  
*(Neni 80 Kushtetutë, neni 97 Rregullore)*
4. [Raport i veprimtarisë së grupit të deputetëve “Miqtë e fëmijëve” për vitin 2020.](#)
5. [Projektligj “Për azilin në Republikën e Shqipërisë”.](#) *(Neni 78 i Kushtetutës dhe nenet 55 dhe 73-77 të Rregullores, shumicë e thjeshtë votash për miratim)*  
Pyetje  
Shprehet nismëtari  
Shprehet komisioni përgjegjës për Sigurinë Kombëtare  
Dhënie mendimi komisioni për Integrimin Europian  
Dhënie mendimi komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut  
Diskutime  
*(Shprehen grupet parlamentare)*  
Koha e votimit në parim, nen/nen, në tërësi
6. [Projektligj “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9251, datë 8.7.2004, “Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”.](#) *(Neni 81 i Kushtetutës dhe nenet 55 dhe 73-77 të Rregullores, shumicë e cilësuar votash për miratim: 3/5 e të gjithë anëtarëve të Kuvendit)*  
Pyetje  
Shprehet nismëtari  
Shprehet komisioni përgjegjës për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin  
Dhënie mendimi komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut  
Diskutime  
*(Shprehen grupet parlamentare)*  
Koha e votimit në parim, nen/nen, në tërësi

7. Projektligj "Për ratifikimin e protokollit ndryshues të marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Kosovës, për shmangien e tatimit të dyfishtë lidhur me tatimet mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin dhe për parandalimin e evazionit fiskal, ratifikuar me ligjin nr.62/2014". *(Neni 121 i Kushtetutës dhe nenet 55 dhe 73-77 të Rregullores, shumicë absolute votash për miratim)*  
Pyetje  
Shprehet nismëtari  
Shprehet komisioni përgjegjës për Ekonominë dhe Financat  
Dhënie mendimi komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut  
Dhënie mendimi komisioni për Politikën e Jashtme  
Diskutime  
*(Shprehen grupet parlamentare)*  
Koha e votimit në parim, nen/nen, në tërësi
8. Projektligj "Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Bashkimit Evropian, në lidhje me programin vjetor kombëtar për Shqipërinë për vitin 2019, në kuadër të instrumentit të asistencës së paraanëtarësimit (IPA II)". *(Neni 121 i Kushtetutës dhe nenet 55 dhe 73-77 të Rregullores, shumicë absolute votash për miratim)*  
Pyetje  
Shprehet nismëtari  
Shprehet komisioni përgjegjës për Ekonominë dhe Financat  
Dhënie mendimi komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut  
Dhënie mendimi komisioni për Politikën e Jashtme  
Dhënie mendimi komisioni për Integrimin Europian  
Diskutime  
*(Shprehen grupet parlamentare)*  
Koha e votimit në parim, nen/nen, në tërësi
9. Projektligj "Për ratifikimin e protokollit ndryshues të marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Dukatit të Madh të Luksemburgut, për shmangien e tatimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal, lidhur me tatimet mbi të ardhurat dhe kapitalin, e nënshkruar në Tiranë më 14 janar 2009, ratifikuar me ligjin nr.10094, datë 12.3.2009". *(Neni 121 i Kushtetutës dhe nenet 55 dhe 73-77 të Rregullores, shumicë absolute votash për miratim)*  
Pyetje  
Shprehet nismëtari  
Shprehet komisioni përgjegjës për Ekonominë dhe Financat  
Dhënie mendimi komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut  
Dhënie mendimi komisioni për Politikën e Jashtme  
Diskutime  
*(Shprehen grupet parlamentare)*  
Koha e votimit në parim, nen/nen, në tërësi
10. Projektvendim "Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës së Institutit të Studimeve të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit në Shqipëri (ISKK)". *(Ligji nr. 10 242, datë 25.2.2010 "Për Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri si dhe nenet 55 dhe 73-77 të Rregullores, shumicë e thjeshtë votash për miratim)*  
Shprehet komisioni përgjegjës për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut  
Diskutime  
*(Shprehen grupet parlamentare)*  
Koha e votimit

11. Projektvendim “Për emërimin e një anëtari të Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare”. *(Neni 78 kushtetutë, nenet 55 dhe 111 Rregullore Kuvendi, votim i fshehtë, shumicë e thjeshtë votash për miratim).*  
Shprehet komisioni përgjegjës për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin  
Diskutime  
*(Shprehen grupet parlamentare)*  
Koha e votimit
  
12. Diskutime për çështje jashtë rendit të ditës (60’).